



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

Numri: KSC-BC-2020-07

Prokurori i Specializuar k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendos: **Paneli i Gjykatës së Apelit**

Gjykatës Mishel Pikar

Gjykatës Emilio Gati

Gjykatës Kai Ambos

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 13 nëntor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Përgjigje e Prokurorisë ndaj apelimit prej Mbrojtjes të vendimit për refuzimin e lirit

Zyra e Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit për Hysni Gucatin

Xhonatan Elistan Ris QC

Mbrojtësit për Nasim Haradinajn

Bastian Martens

I. HYRJE

1. Paneli i Gjykatës së Apelit ('paneli')¹ duhet ta hedhë poshtë menjëherë apelimin² sepse ai bazohet në argumente të mangëta që nuk janë në gjendje të demonstrojnë asnjë gabim në vendimet.³ Edhe nëse apelimi do të konsiderohej në themelësinë e tij, vendimet duhet të lihen në fuqi. Gjykatësi i Vetëm,⁴ i cili kishte autoritet sipas Ligjit⁵ dhe Rregullores⁶ për të urdhëruar arrestimin dhe paraburgimin e Hysni GUCATIT, shqyrtoi faktorët përkatës dhe duke ushtruar si duhej kompetencën e vet të brendaqenësishme, vendosi se vazhdimi i paraburgimit të z. GUCATI është i domosdoshëm. Duke konstatuar se kushtet e nenit 41(6) për arrestim dhe paraburgim ishin plotësuar, Gjykatësi i Vetëm konstatoi drejt se kushtet për lirim të propozuara nga Mbrojtja nuk ishin të mjaftueshme për adresimin e rreziqeve konkrete që z. GUCATI të pengojë zhvillimin e procedurave dhe të kryejë krime të tjera.

II. RRETHANAT DHE HISTORIKU PROCEDURAL

2. Citimi i pasaktë, jo i plotë dhe selektiv i fakteve nga Mbrojtja⁷ duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave dhe historikut procedural të dhënë më poshtë, në të cilat, në fund të fundit, janë bazuar dhe prej të cilave burojnë vendimet.

¹ Vendim për caktimin e panelit të Gjykatës së Apelit, KSC-BC-2020-07/IA001/F00002, 4 nëntor 2020.

² Njoftim për apelim të ndërmjetëm në emër të Hysni GUCATIT ("Apeluesi"), KSC-BC-2020-07/IA001/F00001, 2 nëntor 2020 (njoftuar më 3 nëntor 2020) ('Apeli').

³ Vendim mbi kundërshtimet e Mbrojtjes, KSC-BC-2020-07/F00057, 27 tetor 2020 ('Vendimi për autoritetin'); Vendim mbi kërkesën për dorëzani, KSC-BC-2020-07/F00059, 27 tetor 2020 ('Vendimi për dorëzani'; së bashku me Vendimin për autoritetin, 'Vendimet').

⁴ *Shih* Vendim për caktimin e Gjykatësit të Vetëm sipas nenit 33(2) të Ligjit, KSC-BC-2020-07/F00003, 29 maj 2018. Që nga protokollimi i Apelit, Gjykatësi i Vetëm u caktua Gjykatës i Procedurës Paraprake në këtë çështje. *Shih* Urdhër për parashtrime mbi procedurën e rishikimit të Aktakuzës, KSC-BC-2020-07/F00065, 11 nëntor 2020, konfidencial.

⁵ Ligji Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 3 gusht 2015 ('Ligji'). Të gjitha referencat për 'neni' ose 'nenet' këtu i referohen neneve të Ligjit, përveç nëse është saktësuar ndryshe.

⁶ Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara, KSC-BD-03/Rev3/2020, 2 qershor 2020 ('Rregullorja'). Të gjitha referencat për 'rregulla' or 'rregullat' këtu i referohen Rregullores, përveç nëse është saktësuar ndryshe.

⁷ Apelimi, KSC-BC-2020-07/IA001/F00001, paragrafët 40-47.

A. DOKUMENTET E NXJERRA GJATË HERËS SË PARË

3. Më 7 shtator 2020, z. GUCATI, kryetar i Shoqatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ('OVL-UÇK'), dhe z. HARADINAJ, nënkryetar i OVL-UÇK-së, mbajtën konferencë për shtyp në të cilën z. GUCATI deklaroi se OVL-UÇK-ja kishte marrë dosje që kishin të bënin me Dhomat e Specializuara ('DHS')/ZPS-në ('dokumentet e nxjerra gjatë herës të parë').⁸ Z. GUCATI më tej ia dha fjalën z. HARADINAJ.⁹ Në praninë e z. GUCATI, z. HARADINAJ, ndër të tjera: (i) i bëri publike emrat, vendet e banimit dhe të punës, dhe/ose të dhënat e tjera personale të dëshmitarëve (të mundshëm);¹⁰ (ii) shpjegoi se emrat, vendet e banimit, numrat e telefonit dhe të dhënat e tjera personale, deklaratat, dhe informacioni në lidhje me intervistat e dëshmitarëve të tjerë (të mundshëm) ishin në dokumentet e nxjerra gjatë herës të parë;¹¹ (iii) pranoi se dokumentet ishin konfidenciale;¹² (iv) pranoi dëmin dhe rreziqet që nxjerrja e informacionit paraqiste për dëshmitarët (e mundshëm);¹³ (v) deklaroi se OVL-UÇK-ja do të shpërndante dokumentet që ishin pjesë e dokumenteve të nxjerra gjatë herës të parë;¹⁴ dhe (vi) në mënyrë të përsëritur deklaroi dhe demonstroi se qëllimi i dokumenteve të nxjerra gjatë herës të parë ishte që të pengohej DHS/ZPS-ja.¹⁵

4. Më 7 shtator 2020, Gjykatësi i Vetëm autorizoi sekuestrimin e dokumenteve që ishin pjesë e dokumenteve të nxjerra gjatë herës të parë, konfirmoi natyrën konfidenciale dhe jopublike të hetimeve të TFHS/ZPS-së dhe urdhëroi që personat të cilët posedonin dokumentet ose përmbajtjen e tyre, të mos i kopjonin, incizonin ose shpërndanin ato ('urdhri i parë').¹⁶

⁸ Shtojca 1 e Kërkesës për fletarrestime dhe urdhra të lidhura me të, KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01 ('Transkriptet e Konferencës për Shtyp'), f. 1.

⁹ Transkriptet e Konferencës për Shtyp, KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01, f. 1.

¹⁰ Transkriptet e Konferencës për Shtyp, KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01, f. 2.

¹¹ Transkriptet e Konferencës për Shtyp, KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01, faqet 2-3, 5.

¹² Transkriptet e Konferencës për Shtyp, KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01, f. 4.

¹³ Transkriptet e Konferencës për Shtyp, KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01, faqet 4-5.

¹⁴ Transkriptet e Konferencës për Shtyp, KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01, faqet 1, 3-5.

¹⁵ Transkriptet e Konferencës për Shtyp, KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01, faqet 1-6.

¹⁶ URJENT Vendim për autorizimin e sekuestrimit, KSC-BC-2020-07/F00005, 7 shtator 2020.

5. Më 8 shtator 2020, ZPS-ja dorëzoi urdhrin e parë dhe sekuestroi dokumentet në ambientet e OVL-UÇK-së.¹⁷ Materialet e sekuestruara përfshinin informacion konfidencial dhe jopublik në lidhje me hetimet konfidenciale, ndër të tjera identitetin, të dhënat personale dhe dëshmitë e dëshmitarëve (të mundshëm).¹⁸

B. DOKUMENTET E NXJERRA GJATË HERËS SË DYTË

6. Më 16 shtator 2020, z. GUCATI dhe z. HARADINAJ mbajtën konferencë për shtyp ('konferenca e dytë për shtyp') në të cilën z. GUCATI deklaroi se OVL-UÇK-ja kishte marrë një paketë tjetër dokumentesh që kishin të bënin me DHS/ZPS-në ('dokumentet e nxjerra gjatë herës së dytë').¹⁹ Ndërsa po tregonte njërin nga dokumentet, z. GUCATI i përmendi me emër dy persona që kishin bashkëpunuar me TFHS-në dhe demonstroi njohuri për përmbajtjen së paku të pjeshme të dokumenteve të nxjerra gjatë herës së dytë.²⁰ Z. GUCATI më tej ia dha fjalën z. HARADINAJ.²¹

7. Në praninë e z. GUCATI, z. HARADINAJ, ndër të tjera: (i) përsëriti emrin e një personi që tashmë ishte përmendur nga z. GUCATI;²² (ii) përmendi me emër një person tjetër që kishte bashkëpunuar me TFHS-në;²³ (iii) zbuloi informacion konfidencial dhe jopublik të mëtejshëm në lidhje me hetimet konfidenciale;²⁴ (iv) u tha të pranishmëve në konferencën e dytë për shtyp se dokumentet ishin të disponueshme për këdo dhe u tha të pranishmëve që t'i merrnin;²⁵ (v) pranoi se publikimi i emrave të dëshmitarëve ishte i paligjshëm;²⁶ (vi) dhe megjithatë premtoi se do të vazhdonte të

¹⁷ Raporti i Prokurorisë në bazë të vendimit KSC-BC-2018-01/F00121, KSC-BC-2020-07/F00008, 21 shtator 2020, konfidencial.

¹⁸ Versioni konfidencial i redaktuar i 'Kërkesë URGJENTE për lëshimin e fletarrestimeve dhe për urdhra në lidhje me to', parashtrimi i protokolluar KSC-BC-2020-07/F00009 i datës 22 shtator 2020, KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED, 1 tetor 2020, konfidencial ('Kërkesë për arrestim'), para. 6.

¹⁹ Transkriptet e Konferencës për Shtyp, KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01, f. 6.

²⁰ Transkriptet e Konferencës për Shtyp, KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01, faqet 7, 10.

²¹ Transkriptet e Konferencës për Shtyp, KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01, f. 7.

²² Transkriptet e Konferencës për Shtyp, KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01, f. 7.

²³ Transkriptet e Konferencës për Shtyp, KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01, f. 7.

²⁴ Transkriptet e Konferencës për Shtyp, KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01, faqet 7-8, 10.

²⁵ Transkriptet e Konferencës për Shtyp, KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01, f. 9.

²⁶ Transkriptet e Konferencës për Shtyp, KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01, f. 9.

shpërndante të gjitha dokumentet që do të vinin në OVL-UÇK;²⁷ dhe (vii) deklaroi në mënyrë të përsëritur se qëllimi i dokumenteve të nxjerra gjatë herës së dytë ishte që të pengonte DHS/ZPS-në.²⁸

8. Më 17 shtator 2020, Gjykatësi i Vetëm autorizoi sekuestrimin e dokumenteve që ishin pjesë e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së dytë, konfirmoi natyrën konfidenciale dhe jopublike të informacionit nga hetimet e TFHS/ZPS-së, dhe urdhëroi që personat të cilët posedonin dokumentet ose përmbajtjen e tyre, të mos i kopjonin, incizonin ose shpërndanin ato ('urdhri i dytë').²⁹ Më vonë atë ditë, ZPS-ja dorëzoi urdhrin e dytë dhe sekuestroi dokumentet në ambientet e OVL-UÇK-së.³⁰ Materialet e sekuestruara përfshinin dokumente (i) që kishin të bënin me hetime konfidenciale të TFHS-së, përfshirë identitetin dhe/ose të dhënat personale të dëshmitarëve (të mundshëm); dhe (ii) ishin pjesë e dokumenteve të konfiskuara më 8 shtator 2020 dhe objekt i urdhrin të dytë.³¹

9. Gjatë sekuestrimit, në përgjigje të pyetjes se pse OVL-UÇK-ja nuk kishte njoftuar ZPS-në ose autoritetet kosovare në vend se t'ia dorëzonte dokumentet mediave, z. GUCATI deklaroi se OVL-UÇK-ja nuk e 'njeh' ZPS-në.³² Z. GUCATI nënshkroi për dorëzimin e urdhrin të dytë.³³

C. DOKUMENTET E NXJERRA GJATË HERËS SË TRETË

10. Më 22 shtator 2020, z. GUCATI dhe z. HARADINAJ mbajtën konferencë për shtyp ('konferenca e tretë për shtyp') në të cilën z. GUCATI deklaroi se OVL-UÇK-ja kishte marrë dokumente, për të cilat ata besonin se kishin rrjedhur prej DHS/ZPS-së ('dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë').³⁴ Z. GUCATI pranoi se nuk ishin të

²⁷ Transkriptet e Konferencës për Shtyp, KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01, f. 10.

²⁸ Transkriptet e Konferencës për Shtyp, KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01, faqet 6-12.

²⁹ Vendim për autorizimin e sekuestrimit, KSC-BC-2020-07/F00007, 17 shtator 2020.

³⁰ Raport i Prokurorisë në pajtim me vendimin KSC-BC-2018-01-F00123, KSC-BC-2020-07/F00028, 29 shtator 2020, konfidencial ('Raporti i dytë i Prokurorisë').

³¹ Kërkesë për arrestim, KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED, para. 8.

³² Raporti i dytë i Prokurorisë, KSC-BC-2020-07/F00028, para. 2.

³³ Raporti i dytë i Prokurorisë, KSC-BC-2020-07/F00028, para. 5.

³⁴ Transkriptet e Konferencës për Shtyp, KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01, f. 12.

autorizuar që t'i zbulonin emrat e përfshirë në dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë.³⁵ Ai më tej e tregoi njërin prej dokumenteve dhe deklaroi:³⁶

Ne i thamë [...] hetuesve të gjykatës speciale se do t'i bënim publike të gjitha dokumentet që do t'i prananim,[...]. Ne duam t'ia tregojmë qytetarëve të Kosovës të vërtetën se kjo gjykatë po përpiqet me të gjitha mjetet që ta 'zhveshë' UÇK-në, por nuk do të ketë sukses. Të gjitha këto falsifikime që i kanë bërë janë më kot.

Z. GUCATI pastaj ia dha fjalën z. HARADINAJ.³⁷

11. Në praninë e z. GUCATI, z. HARADINAJ, ndër të tjera: (i) deklaroi se dokumentet, me sa kuptonte ai, kishin të bënin me një projekt-aktakuzë;³⁸ (ii) duke iu referuar përmbajtjes së dokumentit, përmendi me emër pesë të akuzuar të mundshëm;³⁹ (iii) identifikoi një dëshmitar (të mundshëm) me emër;⁴⁰ (iv) identifikoi persona dhe vendndodhje të tjera të përmendura në dokument;⁴¹ (v) i ftoi të pranishmit që të shihnin, incizonin dhe publikonin përmbajtjen e dokumenteve;⁴² (vi) deklaroi se OVL-UÇK-ja do të merrte dhe shpërndante informacion të mëtejshëm konfidencial dhe jopublik;⁴³ dhe (viii) në mënyrë të përsëritur deklaroi dhe demonstroi se qëllimi i dokumenteve të nxjerra gjatë herës së tretë ishte të pengonte DHS/ZPS-në.⁴⁴

12. Në fund të konferencës së tretë për shtyp, z. GUCATI inkurajoi mediat të botonin informacionin konfidencial, duke deklaruar, 'E keni materialin para jush, sikurse i keni bërë publik emrat e veteranëve të rrejshëm, tregoni të njëjtën guxim'.⁴⁵

³⁵ Transkriptet e Konferencës për Shtyp, KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01, faqet 12-13.

³⁶ Transkriptet e Konferencës për Shtyp, KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01, f. 13.

³⁷ Transkriptet e Konferencës për Shtyp, KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01, f. 13.

³⁸ Transkriptet e Konferencës për Shtyp, KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01, f. 13.

³⁹ Transkriptet e Konferencës për Shtyp, KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01, faqet 13-14.

⁴⁰ Transkriptet e Konferencës për Shtyp, KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01, f. 14.

⁴¹ Transkriptet e Konferencës për Shtyp, KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01, f. 14.

⁴² Transkriptet e Konferencës për Shtyp, KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01, faqet 14-16, 19-20, 22-23.

⁴³ Transkriptet e Konferencës për Shtyp, KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01, faqet 14-16, 20-21.

⁴⁴ Transkriptet e Konferencës për Shtyp, KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01, faqet 12-23.

⁴⁵ Transkriptet e Konferencës për Shtyp, KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01, f. 23.

13. Më 22 shtator 2020, ZPS-ja lëshoi një urdhër për dorëzimin e dokumenteve që ishin pjesë e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së tretë, dhe që personat që posedonin këto dokumente apo përmbajtjen e tyre, të mos i kopjonin, incizonin ose shpërndanin ato ('Urdhri i Tretë').⁴⁶ Në të njëjtën ditë, ZPS-ja dorëzoi urdhrin e tretë dhe sekuestroi dokumentet në ambientet e OVL-UÇK-së.

D. ARRESTIMI DHE PROCEDURAT E LIDHURA ME TË

14. Më 24 shtator 2020, Gjykatësi i Vetëm lëshoi, ndër të tjera fletarrestimin.⁴⁷

15. Më 25 shtator 2020, z. GUCATI u arrestua në Kosovë dhe u transferua në objektin e paraburgimit.⁴⁸

16. Më 29 shtator 2020, Mbrojtja paraqiti, ndër të tjera, (i) mocionin për autoritetin,⁴⁹ ku argumentohej mungesa e autoritetit të Gjykatësit të Vetëm për të lëshuar fletarrestim; dhe (ii) mocionin për dorëzani,⁵⁰ ku kërkohet lirimi i z. GUCATI nën kushte të caktuara.

17. Më 2 tetor 2020, ZPS-ja u përgjigj, duke deklaruar se, ndër të tjera, mocioni për dorëzani dhe mocioni për autoritetin duhej të hidheshin poshtë në tërësinë e tyre.⁵¹

18. Më 27 tetor 2020, pas parashtrimeve të tjera në lidhje me seancën dhe marrjen e vendimeve mbi mocionin për autoritetin dhe mocionin për dorëzani,⁵² Gjykatësi i

⁴⁶ Shtojca 1 e Njoftimit të Prokurorisë dhe kërkesës lidhur me të, KSC-BC-2020-07/F00010/A01, konfidencial.

⁴⁷ Fletarrestim për Hysni GUCATIN, KSC-BC-2020-07/F00012/A01, 24 shtator 2020, konfidencial dhe *ex parte* ('Fletarrestimi'). *Shih gjithashtu* Vendim mbi kërkesën për fletarrestime dhe urdhra për transferim, KSC-BC-2020-07/F00012, 24 shtator 2020 ('Vendimi për arrestim').

⁴⁸ Raport për arrestimin dhe transferimin e Hysni Gucatit në objektin e paraburgimit, KSC-BC-2020-07/F00031, 30 shtator 2020, konfidencial dhe *ex parte*.

⁴⁹ Kundërshtim i ligjshmërisë së arrestimit në pajtim me nenin 41(2 (2): Fletarrestimi është lëshuar pa autoritet të ligjshëm, 29 shtator 2020, KSC-BC-2020-07/F00034 ('Mocioni për autoritetin').

⁵⁰ Kërkesë për dorëzani, 29 shtator 2020, KSC-BC-2020-07/F00038 ('Mocioni për dorëzani'). *Shih gjithashtu* Transkriptimi i paraqitjes së parë, 1 tetor 2020, faqet 17-21.

⁵¹ Përgjigje përmbledhëse ndaj mocioneve të Mbrojtjes që kundërshtojnë ligjshmërinë e arrestimit dhe kërkojnë lirim, KSC-BC-2020-07/F00045, 9 tetor 2020.

⁵² Kërkesë për seancë gojore, KSC-BC-2020-7/F00052, 20 tetor 2020, konfidenciale; Përgjigje e Prokurorisë ndaj kërkesës së Mbrojtjes për seancë gojore, KSC-BC-2020-07/F00053, 21 tetor 2020, konfidenciale; Kërkesë për seancë gojore: Njoftim tjetër në lidhje me Përgjigjen e Prokurorisë ndaj kërkesës së Mbrojtjes për seancë gojore, KSC-BC-2020-07/F00054, 21 tetor 2020, konfidenciale; Kërkesë për përgjigje urgjente nga Dhomat e Specializuara: Në lidhje me F00052 me F00054, KSC-BC-2020-07/F00056, 27 tetor 2020.

Vetëm lëshoi vendimet, ku hidhte poshtë, ndër të tjera, mocionin për autoritetin dhe mocionin për dorëzani.

19. Më 30 tetor 2020, ZPS-ja i parashtrori Gjykatësit të Procedurës Paraprake për konfirmim aktakuzën rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* para.⁵³

20. Më 3 nëntor 2020, u njoftua apelimi. Ai kundërshton (i) autoritetin e Gjykatësit të Vetëm për të arrestuar dhe paraburgosur z. GUCATI ('arsyeja e parë'),⁵⁴ dhe (ii) vendimin e Gjykatësit të Vetëm që refuzon lirimin me kusht ('arsyeja e dytë').⁵⁵

III. PARASHTRIMET

A. APELIMI DUHET TË HIDHET POSHTË PA DISKUTIM

21. Apelimi bazohet në parashtrime të mangëta dhe qartësisht të pabazuara që nuk justifikojnë analiza të hollësishme nga paneli dhe duhet të hidhen poshtë menjëherë në interes të procedurave të drejta, efikase dhe efektive.⁵⁶ Veçanërisht, siç është shtjelluar më poshtë,⁵⁷ apelimi: (i) vetëm sa përsërit argumentet që ishin të pasuksesshme para Gjykatësit të Vetëm, pa demonstruar se hedhja poshtë e tyre përbënte gabim që përlligjte ndërhyrjen e panelit; (ii) nuk merr parasysh dispozitat e qarta të Ligjit; (iii) i shtrembëron dhe injoron pjesët relevante të dokumenteve faktike dhe Vendimeve; (iv) propozon kushte shtesë për lirim, të cilat nuk janë ngritur para Gjykatësit të Vetëm; dhe (v) ndryshe nuk fakton gabimet e pretenduara dhe demonstroi se si kanë ndikuar ato materialisht në vendimet.⁵⁸

⁵³ Parashtrimi i Aktakuzës për konfirmim dhe kërkesat në lidhje me të, KSC-BC-2020-07/F00063, 30 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex arte*. *Shih gjithashtu* Urdhër për parashtrime mbi procedurën e rishikimit të Aktakuzës, KSC-BC-2020-07/F00065, 11 nëntor 2020, konfidenciale.

⁵⁴ Apelimi, KSC-BC-2020-07/IA001/F00001, paragrafët 8-31 (nën titullin, 'Arsyeja e dytë për apelim – Arrestimi dhe paraburgimi i apeluesit nuk ishin të ligjshëm dhe lirimi duhet të urdhërohet në përputhje me nenin 41(2) të Ligjit' (theksimet janë hequr)).

⁵⁵ Apelimi, KSC-BC-2020-07/IA001/F00001, paragrafët 32-58 (nën titullin, 'Arsyeja e dytë për apelim – Apeluesit duhet t'i miratohet dorëzania' (theksimet janë hequr)).

⁵⁶ ICTY, Appeals Chamber, Prosecutor v. Krajišnik, IT-00-39-A, Judgment, 17 March 2009 ('Krajišnik Appeal Judgment'), para.16.

⁵⁷ *Shih* paragrafët 25-26, 30-32.

⁵⁸ *Shih, ngjashëm*, Krajišnik Appeal Judgment, paras 17-27; IRMCT, Appeals Chamber, Prosecutor v. Orić, MICT-14-79, Decision on an Application for Leave to Appeal the Single Judge's Decision of 10 December 2015, 17 February 2016, para.14; ICC, Appeals Chamber, Prosecutor v. Abd-Al-Rahman,

22. Nëse paneli e konsideron apelimin në themelësinë e tij, vendimet duhet të lihen në fuqi, përfshirë edhe për këto arsye.

B. ARSYEJA E PARË: GJYKATËSI I VETËM KISHTE AUTORITET TË URDHËRONTE ARRESTIMIN DHE PARABURGIMIN E Z. GUCATI

23. Siç është konstatuar saktë nga Gjykatësi i Vetëm në vendimin për autoritetin,⁵⁹

(i) Ligji dhe Rregullorja parashohin arrestimin, transferimin, dhe paraburgimin e personave para konfirmimit të aktakuzës;⁶⁰ dhe (ii) Gjykatësi i Vetëm ose Gjykatësi i Procedurës Paraprake, pasi të jenë caktuar, mund të ushtrojnë një autoritet të tillë.⁶¹

24. Mbrojtja nuk provon ekzistencën e asnjë gabimi juridik, e aq më pak që një gabim i tillë të ketë ndikuar materialisht ose të ketë zhvlerësuar vendimin për autoritetin.⁶²

25. Në arsyen e parë, Mbrojtja pak a shumë përsërit fjalë për fjalë parashtrimet tashmë të pasuksesshme para Gjykatësit të Vetëm⁶³ dhe nuk tenton të demonstrojë se refuzimi nga Gjykatësi i Vetëm i këtyre parashtrimeve përbën gabim që përlligjet ndërhyrjen e panelit.

ICC02/05-01/20 OA2, Judgment on the appeal of Mr Ali Muhammad Ali Abd-Al-Rahman against the decision of Pre-Trial Chamber II of 14 August 2020 entitled 'Decision on Defence Request for Interim Release', 8 October 2020 ('Abd-Al-Rahman Decision'), para.16..

⁵⁹ Vendimi për autoritetin, KSC-BC-2020-07/F00057, paragrafët 29-31.

⁶⁰ Neni 39(3). Dispozitat e tjera të Ligjit dhe Rregullores, të lexuara bashkë, përfshirë me nenin 39(3), e pranojnë autoritetin për të lëshuar fletarrestime, vendime, dhe urdhra në lidhje me arrestimin, transferimin, dhe paraburgimin gjatë fazës hetimore. *Shih, për shembull*, nenet 35(2)(h), 39(4); rregullat 48(2), 57(1). Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese ka konstatuar se Rregullorja – përfshirë rregullën 57(1), e cila konkretisht ka të bëjë me paraburgimin para caktimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake – janë në pajtimit me kreun II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. *Në lidhje me rregullën 57(1), Shih* Aktvendim mbi referimin e ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të miratuara nga Plenarja më 29 dhe 30 prill 2020, 22 maj 2020, KSC-CC-PR-2020-09, paragrafët 58-75. *Shih gjithashtu* Vendim për autoritetin, KSC-BC-2020-07/F00057, para. 29 (duke marrë parasysh se standardi për arrestim ('dyshimi i bazuar') është më i ulët se standardi që kërkohet për aktakuzë ('dyshim i bazuar mirë'), që bën të ditur se një person mund të arrestohet pa u ngritur aktakuza kundër tij).

⁶¹ Neni 25(1)(a), (f), 33(1)(a), (2). Në Rregullore, 'paneli', i cili përkufizohet se përfshin një 'gjykatës të caktuar në përputhje me nenet 25(1) dhe 33 (*Shih* rregulla 2(1)), ka kompetencë të lëshojë fletarrestime, vendime, dhe urdhra në lidhje me arrestimin, transferimin, dhe paraburgimin. *Shih, për shembull*, rregullat 48(2), 50, 53, 56, 57(1). *Shih gjithashtu*, KSC-BC-2020-07/F00057, para. 30.

⁶² Krajišnik Appeal Judgment, para.12. See also Abd-Al-Rahman Decision, paras 14, 16.

⁶³ *Krahasoni* Apelim, KSC-BC-2020-07/IA001/F00001, paragrafët 8-15, 17-25, 30-31 me Mocionin për autoritetin, KSCBC- 2020-07/F00034, paragrafët 1-17.

26. I vetmi argument i Mbrojtjes që nuk është shqyrtuar dhe refuzuar nga Gjykatësi i Vetëm – konkretisht, se vetëm ZPS-ja, jo një gjykatës i DHS-së, mund të arrestojë dhe paraburgosë një person në fazën hetimore⁶⁴ – është i palogjikshëm dhe i pabazë. Mbrojtja injoron nenin 41(3), i cili parasheh që një gjykatës i DHS-së duhet të vendosë për paraburgimin ose lirimin e çdo personi të privuar nga liria pa urdhër të DHS-së,⁶⁵ dhe dispozitat e tjera të Ligjit dhe të Rregullores që parashohin kompetenca për gjykatësit e DHS-së për të urdhëruar arrestimin dhe paraburgimin para konfirmimit të aktakuzës.⁶⁶

C. ARSYEJA E DYTË: GJYKATËSI I VETËM KONSTATOI SAKTË SE VAZHDIMI I PARABURGIMIT ISHTE I DOMOSDOSHËM

27. Siç është konstatuar saktë nga Gjykatësi i Vetëm në vendimin për dorëzani, vazhdimi i paraburgimit të z. GUCATI është i domosdoshëm dhe proporcional sepse, siç kërkohet prej nenit 41(6): (i) ekziston dyshimi i bazuar se ai ka kryer krime nën juridiksionin e DHS-së; (ii) ekzistojnë rreziqe konkrete se ai do të arratiset, pengojë procedurat dhe kryejë krime të tjera,⁶⁷ dhe (iii) kushtet e propozuara nga Mbrojtja nuk janë të mjaftueshme për adresimin e rrezikut që z. GUCATI do të pengojë procedurat ose kryejë krime të tjera.⁶⁸ Gjithashtu, që nga vendimi mbi dorëzanimin, në interes të procedurave të shpejta, përfshirë minimizimin e kohëzgjatjes së çfarëdo paraburgimi, tashmë është paraqitur aktakuza dhe aktualisht është duke u rishikuar.

28. Vendimi për dorëzani është marrë mbi bazën e kompetencës së brendaqenësishme të Gjykatësit të Vetëm.⁶⁹ Rrjedhimisht, paneli nuk duhet të bëjë

⁶⁴ Apelimi, KSC-BC-2020-07/IA001/F00001, paragrafët 26-29.

⁶⁵ *Shih gjithashtu* Vendim për autoritetin, KSC-BC-2020-07/F00057, para. 29.

⁶⁶ *Shih* shënimin 60 më lart.

⁶⁷ *Shih* Vendimin për arrestim, KSC-BC-2020-07/F00012, pjesa IV(B). *Shih gjithashtu* Vendim për dorëzani, KSC-BC-2020-07/F00059, para 12 (meqenëse Mbrojtja nuk i ka argumentuar kundërshtimet e ekzistencës së dyshimit të bazuar dhe nuk e ka kundërshtuar vlerësimin e mëparshëm të rrezikut sipas nenit 41(6)(b), Gjykatësi i Vetëm nuk iu është referuar konstatimeve të veta këtu).

⁶⁸ Vendimi për dorëzani, KSC-BC-2020-07/F00059, paragrafët 12, 16-20. *Shih gjithashtu* neni 41(12) (identifikimi i masave, përveç paraburgimit që mund të urdhërohen 'për të parandaluar përsëritjen e krimit ose për të garantuar zhvillimin e suksesshëm të procedurave penale').

⁶⁹ Neni 41(12) (me kusht që masat përveç paraburgimit 'mund të urdhërohen nga Dhomat e Specializuara'). *Shih gjithashtu* TPNJ, ICTY, *Prosecutor v. Mladić, Appeals Chamber, IT-09-92-AR65.1*,

rishikim *de novo*.⁷⁰ Me rëndësi është se a e ka ushtruar drejt Gjykatësi i Vetëm këtë kompetencë kur e ka marrë vendimin për dorëzani, dhe jo se a pajtohet paneli.⁷¹ Paneli duhet të lerë në fuqi vendimin për dorëzani sepse Mbrojtja nuk ka arritur të demonstrojë se ai: (i) u bazua në interpretim të gabuar të ligjeve në fuqi; (ii) u bazua në konstatim të gabuar të fakteve; ose (iii) ishte aq i padrejtë dhe i paarsyeshëm sa që përbën keqpërdorim të kompetencës.⁷² Gjithashtu, Gjykatësi i Vetëm nuk u kushtoi rëndësi faktorëve anësorë dhe të parëndësishëm, por u kushtoi rëndësi të mjaftueshme faktorëve të rëndësishëm për marrjen e vendimeve.⁷³

29. Gjatë marrjes së vendimit, Gjykatësi i Vetëm i vlerësoi rreziqet e lirit të z. GUCATI nën kushtet e propozuara për lirim.⁷⁴ Në këtë kontekst, ai gjykoi drejt se: (i) z. GUCATI mori pjesë në shpërndarjen e paautorizuar të informacionit konfidencial dhe jopublik; (ii) kjo shpërndarje vazhdoi pas urdhrit të parë dhe urdhrit të dytë; (iii) z. GUCATI deklaroi publikisht se ai dhe OVL-UÇK-ja do të vazhdonin t'i bënin publike dokumentet që do të merrnin dhe i inkurajoi mediat të bënin të njëjtën gjë; (iv) nëse lirohet, z. GUCATI 'do të ishte në gjendje që të merrte pa mbikëqyrje, informacion konfidencial dhe jopublik' dhe 'do të kishte gjithashtu mjete për shpërndarjen e atij informacioni duke komunikuar lirisht me mediat ose me rrjetin e tij të veteranëve të UÇK-së, ose duke e publikuar materialin vet'; dhe (v) çdo zotim personal për t'iu përmbajtur kushteve nuk mund të besohet duke pasur parasysh deklaratat publike të z. GUCATI ku betohet se do të vazhdojë të nxjerrë informacione konfidenciale dhe jopublike dhe refuzimit që t'u bindet urdhrave të Gjykatësit të Vetëm.⁷⁵

Public Redacted Version of "Decision on Interlocutory Appeal Against Decision on Urgent Defence Motion for Provisional Release" Issued on 27 June 2017, 30 June 2017 ('Mladić Decision'), para.3..

⁷⁰ Mladić Decision, para.3. *Shih gjithashtu Abd-Al-Rahman Decision, para.13.*

⁷¹ Mladić Decision, para.3. *Shih gjithashtu Abd-Al-Rahman Decision, para.15.*

⁷² Mladić Decision, para.4. *Shih gjithashtu Abd-Al-Rahman Decision, para.13.*

⁷³ Vendimi për *Mlladiqin*, paragrafët 4, 6. *Shih gjithashtu Abd-Al-Rahman Decision, para.14-15.*

⁷⁴ Vendimi për dorëzani, KSC-BC-2020-07/F00059, paragrafët 12, 16-21. *Apelimi Contra, KSC-BC-2020-07/IA001/F00001, para. 55.*

⁷⁵ Vendimi për dorëzani, KSC-BC-2020-07/F00059, para. 17. *Shih, ngjashëm, ICC, Appeals Chamber, Prosecutor v. Gbagbo, ICC-02/11-01/11-278-Red, Judgment on the appeal of Mr Laurent Koudou*

30. Thjesht përsëritja e parashtrimeve nga Mbrojtja, të cilat ishin të pasuksesshme para Gjykatësi të Vetëm⁷⁶ nuk mund të demonstrojnë se refuzimi i këtyre parashtrimeve nga Gjykatësi i Vetëm ishte gabim që përligj ndërhyrjen e panelit. Mbrojtja gjithashtu propozon kushte të reja për lirim që nuk iu paraqitën Gjykatësit të Vetëm,⁷⁷ të cilat nuk duhet të konsiderohen për herë të parë në apelim⁷⁸ dhe sidoqoftë, janë detyrimisht jo të mjaftueshme, duke qenë se ende bazohen në zotimet personale të z. GUCATI.⁷⁹

31. Gjithashtu, Mbrojtja i shtrembëron ose nuk i merr parasysh, ndër të tjera, këto pjesë të dokumenteve faktike, që gjithashtu demonstrojnë rreziqet e lirim të z. GUCATI dhe kushteve të pamjaftueshme për lirim të propozuara nga Mbrojtja:

- i. Z. GUCATI dhe z. HARADINAJ, në praninë e z. GUCATI, pranuan se ishin të vetëdijshëm për natyrën konfidenciale dhe jopublike të informacionit që nxorën në mënyrë të paautorizuar;⁸⁰
- ii. Z. HARADINAJ, në praninë e z. GUCATI, pranoi dëmin dhe rreziqet për dëshmitarët (e mundshëm) që paraqiste shpërndarja e paautorizuar e informacionit konfidencial dhe jopublik që i identifikonte ata;⁸¹
- iii. Z. GUCATI pranoi se nuk kishin qenë të autorizuar që të zbulonin emrat në dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë;⁸²
- iv. Z. HARADINAJ, në praninë e z. GUCATI, pranoi se shpërndarja e identitetit të dëshmitarëve (të mundshëm) mund të ishte e paligjshme;⁸³
- v. Z. GUCATI dhe z. HARADINAJ, në praninë e z. GUCATI, në mënyrë të përsëritur inkurajuan shpërndarjen e mëtejme të informacionit konfidencial

Gbagbo against the decision of Pre-Trial Chamber I of 13 July 2012 entitled "Decision on [...]", 26 October 2012, para.80.

⁷⁶ *Krahaso* Apelim, KSC-BC-2020-07/IA001/F00001, paragrafët 32-36, 38, 47-51, 54 *me* Mocion për dorëzani, KSC-BC-2020-07/F00038, paragrafët 1-6.

⁷⁷ *Apelim*, KSC-BC-2020-07/IA001/F00001, para. 54.

⁷⁸ *Shih* para. 21 më lart.

⁷⁹ *Shih* Vendim për dorëzani, KSC-BC-2020-07/F00059, para. 17.

⁸⁰ *Shih, për shembull*, paragrafët 3, 10 më lart. *Apelim Contra*, KSC-BC-2020-07/IA001/F00001, para. 46.

⁸¹ *Shih, për shembull*, para. 3 më lart. *Apelim Contra*, KSC-BC-2020-07/IA001/F00001, para. 47.

⁸² *Shih, për shembull*, para. 10 më lart. *Apelim Contral*, KSC-BC-2020-07/IA001/F00001, para. 46.

⁸³ *Shih, për shembull*, para. 7 më lart. *Apelim Contra*, KSC-BC-2020-07/IA001/F00001, para. 46.

dhe jopublik që ka të bëjë me DHS/ZPS-në dhe u zotuan që do të vazhdonin t'i bënin publike të gjitha dokumentet e marra;⁸⁴ dhe

- vi. Z. GUCATI dhe z. HARADINAJ në praninë e z. GUCATI, deklaruan dhe demonstruan në mënyrë të përsëritur qëllimet e tyre për pengimin e DHS/ZPS-së.⁸⁵

32. Së fundi, Mbrojtja gabimisht pretendon se Gjykatësi i Vetëm konstatoi pa të drejtë se z. GUCATI nuk u ishte bindur urdhrave të Gjykatësit të Vetëm.⁸⁶ Ndërsa urdhri i parë dhe urdhri i dytë kishin të bënin me dokumente të caktuara,⁸⁷ ata pranuan në përgjithësi natyrën konfidenciale dhe jopublike të informacionit nga hetimet e TFHS/ZPS-së, i cili nuk duhet të shpërndalet pa autorizim.⁸⁸ Rrjedhimisht, duke konstatuar se zotimet personale për respektimin e kushteve ishin garanci e pamjaftueshme për të garantuar respektimin e tyre, Gjykatësi i Vetëm me arsye u bazua, ndër të tjera, në pjesëmarrjen e vazhdueshme të z. GUCATI në shpërndarjen e informacionit konfidencial dhe jopublik pas nxjerrjes së urdhrin të parë dhe urdhrin të dytë,⁸⁹ ky i fundit iu dorëzua z. GUCATI personalisht.⁹⁰ Mbrojtja nuk merr parasysh se, pavarësisht nga fushëveprimi i urdhrin të parë dhe urdhrin të dytë,⁹¹ z. GUCATI ka qenë i vetëdijshëm për natyrën konfidenciale dhe jopublike të informacionit që është shpërndarë dhe se nuk duhet të shpërndalet pa autorizim.⁹²

IV. MASA QË KËRKOHET

33. Për arsyet e lartpërmendura, paneli duhet ta hedhë poshtë në tërësi apelimin.

⁸⁴ *Shih* paragrafët 3, 6-7, 9-12 më lart.

⁸⁵ *Shih* paragrafët 3, 6-7, 9-12 më lart.

⁸⁶ Apelim, KSC-BC-2020-07/IA001/F00001, para. 56.

⁸⁷ Urdhri i parë, KSC-BC-2020-07/F00005, para. 22; Urdhri i dytë, KSC-BC-2020-07/F00007, para. 22.

⁸⁸ Urdhri i parë, KSC-BC-2020-07/F00005, paragrafët 11-13; Urdhri i dytë, KSC-BC-2020-07/F00007, paragrafët 11-13. *Shih gjithashtu* paragrafët 4, 8 më lart.

⁸⁹ *Shih* paragrafët 6-7, 10-12 më lart.

⁹⁰ *Shih* para. 8 më lart.

⁹¹ Gjithashtu, dokumentet e caktuar ishin pjesë e dokumenteve të nxjerra për herë të dytë, dhe për këtë arsye objekt i Urdhrin të parë. *Shih* para. 8 më lart.

⁹² *Shih* para. 31 më lart.

Numri i fjalëve: 3880 /në origjinal/

/nënshkrimi/

Xhek Smith

Prokurori i Specializuar

E premte, 13 nëntor 2020

Në Hagë, Holandë